



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEKANATI

Nr. 475 prot.

Tiranë, më 04.11.2022

V E N D I M

Nr. 74 Datë 04.11.2022

PËR VENDOSJEN E NJË AFATI SI PERIUDHË TRANZICIONI TË NDRYSHIMIT TË PLANEVE MESIMORE

Sezoni i Vjeshtës shtator 2022, shënon përfundimin e afatit të planit mësimor të vitit akademik 2017-2018. Bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, për studentët e vitit 5-të të cilët nuk përfunduan studimet janë studentë përsëritës dhe i nënshtrohen ndryshimeve të planit mësimor të vitit akademik që i bashkangjiten. Efekti i menjëhershëm i ndryshimit të planeve mesimore pikërisht studentëve përsëritës të vitit të pestë, u sjell ndryshime në shtim të lëndëve në vite të ndryshme. Në këtë mënyrë Dekani shqyrtoi kërkesën e të gjithë studentëve pranë Dekanatit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, analizoi në detaj problematikat që dalin nga ky ndryshim dhe në konsultim me Drejtorinë e Kurrikulave,

V E N D O S I

Për të gjithë studentët e vitit 5-të të cilët kanë realizuar të gjithë frekuentimin e lëndëve të planit mësimor 2017-2018 dhe kanë vetëm provime/projekte/detyra apo/dhe studion e diplomës për të frekuentuar/kontrollet/mbrojtjen, të vendosi një afat deri në vjeshtën e vitit 2023 për të kryer të gjitha provimet/projektet/detyrat. Në rastet se brenda këtij afati studentët përsëritës të vitit të 5-të nuk mbyllin 270 kredite, atëherë ato do të nënshtrohen planit të ri mësimor të cilët ata do të bashkangjiten në vitin përkatës, duke ndjekur të gjitha detyrimet që lindin nga ndryshimi i planeve mesimore. Studentët të cilët kanë ende lëndë të tjera për të frekuentuar krahas studjos së diplomës, do të nënshtrohen planit mësimor 2018-2019 për këtë vit akademik 2022-2023.

DEKANI

Prof. Dr. Armand YORSHI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEKANATI

Nr. 475/1 prot.

Tiranë, më _____.____.2022

Lënda: Saktësim lidhur me Vendimin për vendosjen e një afati si periudhë tranzicioni të ndryshimit të planeve mësimore

DEPARTAMENTEVE

SEKRETARISË MËSIMORE

Këtu

Bazuar në Vendimin Nr. 74, datë 04.11.2022, Nr. 475 Prot. saktësojmë se:

1. Të gjithë studentët e vitit 5-të të cilët kanë realizuar të gjithë frekuentimin e lëndeve të planit mësimor 2017-2018 dhe kanë vetëm provime/projekte/detyra apo/dhe studion e diplomës për të frekuentuar/kontrollet/mbrojtjen, të vendosi një afat deri në vjeshtën e vitit 2023 për të kryer të gjitha provimet/projektet/detyrat dhe detyrimet e studjos së diplomës me 30 kredite.
2. Në rastet se brenda këtij afati studentët përsëritës të vitit të 5-të nuk mbyllin 270 kredite, dhe nuk kanë kryer detyrimet e lëndës Studjo diplome (30 kredite), bazuar dhe në rregulloren e diplomës të vitit akademik 2021-2022, atëherë ato do të nënshtrohen planit të ri mësimor të vitit pasardhës duke ndjekur të gjitha detyrimet që lindin nga ndryshimi i planeve mësimore.
3. Studentët e vitit 5-të përsëritës të cilët kanë ende lëndë të tjera për të frekuentuar (për vitin akademik 2022-2023) krahas lëndës së studjos së diplomës, do të nënshtrohen planit mësimor 2018-2019 për këtë vit akademik 2022-2023 duke ndjekur të gjitha detyrimet që lindin nga ndryshimi i planeve mësimore.

DEKANI

Prof. Dr. Armand VOKSHI